

VENDIM
Nr. 904, datë 11.11.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË PËRFITUESVE, TË MASAVE E TË
KRITEREVE PËR SIGURIMIN E JETËS SË PUNONJËSIT TË POLICISË
USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40, të ligjit nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës në masën deri në 2% të personelit, sipas tabelës së organizimit dhe të pajisjeve të punonjësve të Policisë Ushtarake.
2. Kategoritë që përfitojnë sigurim jete janë:
 - a) punonjësit, të cilëve, për shkak të detyrës funksionale, u rrezikohet jeta, si më poshtë vijon:
 - Oficerë të Policisë Gjyqësore;
 - Inspektorë dhe agentë të Policisë Kriminale;
 - Inspektorë të qarkullimit rrugor;
 - Inspektorë të rendit ushtarak.
 - b) punonjësit e tjerë, të cilët vënë jetën në rrezik dhe që përcaktohen në urdhrin e Komandantit të Policisë Ushtarake për kryerjen e detyrave operacionale.
3. Kriteret për të përfituar sigurim të jetës janë, si më poshtë vijon:
 - a) Humbja e jetës të ketë ndodhur gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;
 - b) Punonjësi i Policisë Ushtarake duhet të jetë deklaruar i vdekur nga organet kompetente mjekësore ose të jetë shpallur i vdekur me vendim gjykatë.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama